



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

KËSHILLI I FAKULTETIT

Ekstrakt nga Procesverbali, Dt.24.05.2021, ora 11,00

Prezent,

Anëtarët prezent të Këshillit ;

<i>Nr.</i>	<i>Thirrja akad.</i>	<i>Emri</i>	<i>Mbiemri</i>	<i>Pozita</i>
1.	<i>Prof.Asoc.Dr.</i>	<i>Musa</i>	<i>Selimi</i>	<i>Dekan</i>
2.	<i>Prof.Ass.Dr.</i>	<i>Florian</i>	<i>Miftari</i>	<i>Prodekan për mësim</i>
3.	<i>Prof.Dr.</i>	<i>Hasim</i>	<i>Rushiti</i>	<i>Prodekan për shkencë</i>
4.	<i>Prof.Ass.Dr.</i>	<i>Shqipe</i>	<i>Bajçinca</i>	<i>Senatore</i>
5.	<i>Prof.Asoc.Dr.</i>	<i>Bylbyl</i>	<i>Sokoli</i>	<i>Prodekan për financa</i>
6.	<i>Prof.Asoc.Dr</i>	<i>Abdulla</i>	<i>Elezi</i>	<i>Prof.</i>
7.	<i>Prof.Dr.</i>	<i>Bujar</i>	<i>Turjaka</i>	<i>Prof. Koordin. ECTS</i>
8.	<i>Prof.Asoc.Dr.</i>	<i>Afrim</i>	<i>Koca</i>	<i>Prof.</i>
9.	<i>Prof.Asoc.Dr.</i>	<i>Hazir</i>	<i>Salihu</i>	<i>Prof.</i>
10.	<i>Prof.Dr.</i>	<i>Naser</i>	<i>Rashiti</i>	<i>Prof.</i>
11.	<i>Prof.Ass.Dr.</i>	<i>Bahri</i>	<i>Gjinovci</i>	<i>Prof.</i>
12.	<i>Dr.sc.Ass.</i>	<i>Faton</i>	<i>Tishukaj</i>	<i>Ass.</i>
13.	<i>Prof.Ass.Dr.</i>	<i>Besim</i>	<i>Halilaj</i>	<i>Prof.</i>
14.	<i>Prof.Ass.Dr</i>	<i>Malsor</i>	<i>Gjonbalaj</i>	<i>Prof.</i>
15.	<i>Prof.Asoc.Dr.</i>	<i>Ajvaz</i>	<i>Berisha</i>	<i>Prof.</i>
16.	<i>Prof.Asoc.Dr.</i>	<i>Aziz</i>	<i>Dujaka</i>	<i>Prof.</i>
17.	<i>Mr.sc.Ass.</i>	<i>Ilir</i>	<i>Gllareva</i>	<i>Ass. Zyrt. i Institutit</i>
18.	<i>MSc. Ass.</i>	<i>Kushtrim</i>	<i>Berisha</i>	<i>Ass.</i>
19.	<i>Student</i>	<i>Shkelqim</i>	<i>Sadriu</i>	<i>Student</i>
20.	<i>Student</i>	<i>Drin</i>	<i>Ferataj</i>	<i>Student</i>
21.	<i>Administratë</i>	<i>Florije</i>	<i>Ismajli</i>	<i>Bibliotekiste</i>
22.	<i>Dr.sc.</i>	<i>Gani</i>	<i>Ibrahimi</i>	<i>Sekretar-Ex-oficio</i>

Rend Dite :

1. Shqyrtimi i plan-programit mësimor për Ri-akreditim, Master Edukim Fizik dhe Sport

Seancën e udhëhoqi, **Dekani, Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi.**

Fillimisht, aprovoi rendin e takimit.

Njoftoi, që përveç, detyrave të tjera, ne po tregohemi serjuz në atë që jemi të thirrur sot në Këshillin e Fakultetit për një pikë shumë të rëndësishme.

Agjendat, për pergaditjen e një draft-programi për ri-akreditim përkatësisht në sudimet Master, programi 2-vjeçar, janë me detyrë primare.

Ju ftoj në kontributin e sejcilit, që t'a shfrytëzojmë mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të programit deri në 20%, por edhe t'a avansojmë edhe më tutje programin në ri-akreditim që është



sidomos për gjeneratat që kanë përfunduar studimet 3 vjeçare me 180 ECTS të tubuara, për tu kompletuar edhe me 120 të tjera me të drejtë pune në arsim shkollor.

Gjithëherë koha është pak, andaj ju lutem na duhet një mobilizim i të gjithëve.

Dr.sc. Florian Miftari: Prodekan për mësim, ju ftoj të gjithëve po edhe koordinatoren për ECTS, z.Turjaka që ka edhe kompetenca me detyrë, për informata shtesë nga Zyra për Zhvillime Akademike në UP, për programin që e kemi në ri-akredim.

Unë them që duhet të kontribuojmë, por edhe të infomojmë gjithë stafin akademik, se çka duhet ndryshuar si nevojë, prej momentit të akreditimit të programeve nga hera e fundit e deri më sot, e sidomos për Masterin 2-vjeçar që po debatohet sot.

Mendoj se duhet të kemi një koordinim me MASHT-tin. Të koordinohemi me programet tona, karshi atyre kurrikulave mësimore dhe anasjelltas. Programet, duhet të qëndrojnë duke ruajtur përmbajtjen edhe atë tradicionale Edukata fizike dhe shëndetësore.

Që mësimdhënës, në të gjitha nivelet, duhet të jenë ata që mbarojnë FEFS-in, me programe të avansuara (edukim fizik dhe sport).

Ne duhet të prodhojmë kuadër sipas kërkesave të tregut.

Ndryshimet t'i bashkryesojmë bashkë me ekspertët vendor dhe ata të jashtëm. Ta rrisim numrin e fondit të orëve nga Edukata fizike, në të mirë të shëndetit të nxënësve dhe popullatës.

Të rrisim fondin e orëve edhe te programet tona Bachelor dhe Master, sidomos te lëndët në lojërat sportive. Në këtë trend mbulohen me kuadro profesionale institucionet shkollore dhe sportive që kanë shumë nevojë për ekspert të kësaj lëmie.

Unë kam sjellë një model, shumë funksional, nga Zagrebi që në të ardhmen e afërt mundë ta zbatojmë edhe ne. Sikur ata, programet i kanë në vazhdimsi, nga Viti i I-rë, deri në të V-tin (të inkorporuara), që llogariten, studimet themelore dhe ato master.

Në konkluzione të draft programit, unë ofroj propozimet që i kam sjellë me shkrim.

Mendoj se duhet ta hartojmë një RVV, sipas standarit siç e kërkojnë ekspertët ndërkombëtar.

Prof.Dr. Hasim Rushiti : Programet ekzistuese kanë nevojë për plotësime. Natyrisht ka nevojë për ndryshime, apo rifreskim. Unë do ta jap kontributin tim në aspektin e lëndëve që janë me proritete dhe që ofrojnë kërkesa për hulumtime shkencore. Në këtë drejtim presim edhe nga koordinatori për ECTS, i cili besoj se duhet të ketë më shumë informata e njohuri, por këte po e them për afate dhe procedura.

Prof.Asoc.Dr. Hazir Salihu: Ne duhet ti shohim mundësitë dhe të kemi forcë, që me propozime konkrete para zyrtarëve për akreditim, ta shfrytëzojmë mundësinë që së paku 20% ta ndryshojmë programin ekzistues.

Prof.Ass.Dr. Malsor Gjonbalaj: Unë kam disa propozime, dhe me shumë të tjera që po pajtohem me parafolësit:

- Për emërtimin e lëndëve, të pyeten edhe mësimdhënësit apo bartësit e lëndës.

- Lëndët zgjedhore, të kenë fondin e orëve 2+1.

Shkëlqim Sadriu-Student: Është e domosdoshme që të riakreditohet programi Master dy vjeçar me 120 ECTS, për shkak se shumë student që kanë diplomuar këtu e që janë nëpër vende pune vetëm me 180 ECTS, ju rrezikohet vendi i punës.

Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi, Dekan:

Të shtojmë lëndë të reja zgjedhore, aty ku ka mundësi dhe që janë në trend dhe shumë atraktive, por që njifen edhe si sport Olimpik.

Nga Takimi dhe diskutimet e anëtarëve të këshillit , nxirren këto propozime dhe konkluzat:
Ndyshimet në vitin e I-rë, të studimeve Master.

1. Metodatat e avansuara për vlerësim trupor, nga lënda obligative të kaloi në lëndë zgjedhore dhe të Riemërtohet: Vlerësimi i aplikuar i përbërjes tupore.
2. Të rriten grupet e studentëve (në ligjerata) e që kjo rritë edhe fondin e orëve.
3. Lënda Gjuhë Angleze të Ri-emërtohet Shkrim akademik (English)
4. Kursi i avansuar i Biomekanikës që mbahet në Semestrin e II-të, të kaloi në Semestrin e I-rë (lënda mbetet obligative)
5. Lënda Metodatat kërkimore në Edukim Fizik dhe Sport, të rritete numri i kredive nga 6 ECTS, në 7 ECTS dhe të bëhet lëndë 2(dy) semestrare.
6. Kursi i Avansuar në TTS, nga 5 ECTS, të rritet për një kredi gjegjësisht në 6 ECTS.
7. Mësimdhënia e fëmijëve dhe adoleshentëve për Edukim fizik dhe sport, nga lëndë obligative, të kalon në statusin e lëndës zgjedhore dhe të emërtohet: Mësimdhënia në shkollë në nivelin parafillor dhe fillor dhe nga 5 ECTS sa kishte të ketë 4 ECTS.
8. Lënda: Punë praktike (Intership) propozohet të largohet nga programi, pasi shumë student e staf akademik janë të kyqur në klube dhe asociacione sportive dhe marrin përvojë të mjaftueshme..

Ndyshimet në vitin e II-të, të studimeve Master.

1. Lënda: Shëndeti, mirëqenia dhe administrimi i fitnesit të emërtohet: Shëndeti, mirëqenia dhe administrimi i Rekreacionit.
2. Lënda Lidershipi dhe menaxhmenti në Sport të E.F.S, t'i ndërrohet statusi nga obligative në lëndë zgjedhore dhe nga 6 ECTS sa kishte, të ketë vetëm 4 ECTS.
3. Lënda të Ushqyerit në sport, shëndet dhe mirëqenie nga statusi i lëndës që ka pas si zgjedhore, të kaloi në lëndë obligative me emërtim të ri në: Nutricioni për sport, shëndet dhe mirëqenie me dy kredi më shumë në 6 ECTS, se sa kishte më parë vetëm 4 ECTS.


Konkluzionet dhe propozimet të debatohen, apo të fuzionohen si një Vendim i përbashkët deri në një program final për Ri-akredim pranë Agjencionit Kosovari të Akreditimit.

Prof.Dr.Bujar Turjaka, Zyrtar për Zhvillime Akedemike; Ne kemi të hartuar sot draft propozimin, e programit për Ri-akreditim nga ky takim e të cilat dalin si Version final pas të gjitha diskutimeve tuaja, dhe të njejtat do t'i dergojmë dhe procedojmë për Akredim në Agjencionin Kosovari të Akreditimit, nga ekspertët ndërkombëtar.

- Një RVV të hartuar nga Komisioni hartues dhe të plotësuar në të gjitha pyetjet e kërkuara. Pjesë e ekstraktit nga Procesverbali i takimit të punës të Këshillit janë të bashkangjitura, Programi ekzistues dhe Draft programi për ndyshimet për ri-akreditim të programit Master .

Pasi u diskutuan pikat përkatëse, Dekani, Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi mbylli seancën e Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në ora 12,¹⁵

**Procesmbajtësi,
Sekretari, Gani Ibrahim**



**Saktësinë e Ekstraktit e verteton
Dekani, Prof.Asoc.Dr. Musa Selimi**